**V E N D I M**
**Nr.294, datë 29.5.1995**

**PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.47, DATË 7.2.1994 "KRITERET E VLERËSIMIT TË PRONËS SHTETËRORE QË PRIVATIZOHET OSE VENDOSET NË SHOQËRITË E PËRBASHKËTA, SI DHE PËRCAKTIMI I QIRASË PËR OBJEKTE SHTETËRORE QË U JEPEN NË PËRDORIM TË TRETËVE"**

Me propozimin e Ministrisë së Burimeve Minerare dhe Energjetike, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.47, datë 7.2.1994, bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën I.1, në fund të paragrafit të parë shtohet: "ndërsa për objektet e filialeve elektroenergjetike ky koeficient nuk merret parasysh. Gjithashtu, për këto filiale sipërfaqja e objekteve elektrike të përcaktohet si më poshtë:

a) Për linjat e tensionit të lartë sipërfaqja që zënë shtyllat metalike, konturi i jashtëm i bazamenteve të tyre, si dhe i tokëzimit plus 1 ml për anë, për shtyllat betonarme të jetë plus 1 ml për anë nga sipërfaqja në planimetri,

b) Për nënstacionet, sipërfaqja në planimetri e tyre deri në rrethim.

c) HEC-et me digë, sipërfaqja e ndërtesës së makinerisë digës, ujëmbledhësit, veprave të shkarkimit, tuneleve të furnizimit e shkarkimit dhe gjithë territori, nënstacionet që ndodhen midis objekteve dhe hidrocentralet.

d) Për HEC-et me derivacion, njëlloj me pikën 3, duke përfshirë edhe tubacionin e presionit, basenin e presionit, kanalin e derivacionit e veprën e marrjes.

dh) Për tokën bujqësore skicat miratohen në kadastrën e rrethit ose atë pyjore, sipas kritereve të përcaktuara në këtë vendim."

2. Në pikën I.1, në fund të paragrafit të tretë, pas kllapës shtohet:

"ndërsa për filialet elektroenergjetike titullari "Ministri" miraton VAMI-n dhe objektet për të cilat miratohet VAMI, klasifikohen si më poshtë:

A. Për filialet e shpërndarjes:
1. Linja të tensionit të mesëm
2. Linja të tensionit të ulët
3. Të tjera

B. Për filialet e prodhimit:
1. Linja të TL
2. Nënstacione
3. HEC-e me digë
4. HEC-e me derivacion
5. TEC-e"

3. Në pikat I.2 dhe I.3 në fund të paragrafit të dytë, pas kllapës shtohet:
"ndërsa për filialet elektroenergjetike veprohet si në pikën I.1".

4. Në pikën I.2, në fund të paragrafit të parë shtohet:
"ndërsa për objektet e filialeve elektroenergjetike ky koeficient nuk merret parasysh".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
**Aleksandër Meksi**